



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 266 Prot.

Tiranë, më datë 05.07.2024

VENDIM

Nr. 234, datë 05.07.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 05.07.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në **Vendimin nr. 75 datë 19.02.2020 të KKTKM-së** Për “Miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore”, me **propozim të IKTK**.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI



KRYETAR
Blendi GONXHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1021/Prot.

Tiranë, më datë 01.04 2024

RELACION
MBI
LLOJET E NDËRHYRJEVE ME KARAKTER MIRËMBAJTËS NË
PASURITË KULTURORE

1. Baza Ligjore

- Ligji Nr. 27/2018, datë 27.05.2018 “Për Trashëgimine Kulturore dhe Muzetë”;
- VKM Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale” Kreu II, Pika 13;
- VKM Nr. 364, datë 29.05.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”.
- VKM 1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, Kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”, kapitulli IV;

2. Përkufizime

“Mirëmbajtja” janë të gjitha masat praktike dhe teknike që duhen ndërmarrë, në mënyrë që pasuria kulturore të mbahet në ato lloj kushtesh e standardesh që japin kënaqësinë maksimale, pa dëmtuar vlerat kulturore. Ky është një proces i vazhdueshëm, programi i të cilit monitorohet.¹

Punimet e mirëmbajtjes janë punime periodike rutinë të cilat kryhen me qëllim mbajtjen në gjendje të mirë të strukturave dhe ndërtimeve.²

3. Organizimi dhe përbërja e Këshillit Teknik

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Pranë KKTKM-së funksionon Këshilli teknik i cili ka në përbërje 7 anëtarë, pjesë e 15 anëtarëve të KKTKM-së.

Ky këshill kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe vepron si trupë vlerësuese, shqyrtuese dhe seleksionuese e përputhshmërisë së kërkesave të paraqitura për miratim pranë KKTKM-së.

¹ VKM Nr. 1099, datë 24.12.2020 Për Miratimin e Mënyrave të Trajtimit, Normave Teknike, Kriterëve dhe Modeleve të Ndërhyrjeve në Fushën e Ruajtjes së Pasurive Kulturore

² Conservation Principles Policies and Guidance for the Sustainable Management of the Historic Environment – Historic England 2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Relacioni që i dërgohet KKTKM-së nga ana e Këshillit teknik firmoset nga kryetari.

Përveç çështjeve që, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 janë kompetencë e KKTKM-së, Këshilli Teknik ka kompetencë të miratojë kërkesa apo projekte që lidhen me ndërhyrjet me karakter mirëmbajtje të pasurive kulturore. Në rastin e këtyre ndërhyrjeve Këshilli Teknik shprehet me vendim përfundimtar. Llojet e ndërhyrjeve të këtij lloji, përcaktohen me vendim të KKTKM-së.

4. Objektivi

Ndërhyrje e mirëmbajtjes kanë si objektiv të kufizojnë përkeqësimin, mënjanimin e dëmtimeve të mëtejshme me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së objektit dhe ruajtjes së vlerave kulturore. Inspektimet e kryera në intervale të rregullta, së bashku me veprimet e menjëhershme për parandalimin ose korrigjimin e problemeve, janë baza e mirëmbajtjes efektive.

Mirëmbajtja është efiçiente në kosto. Koha dhe shpenzimet për kujdesin rutinë, studimet e rregullta dhe riparimet e vogla e mbrojnë vlerën e ndërtesës. Mirëmbajtja e mirë gjithashtu ndihmon për të garantuar shëndetin dhe sigurinë e përdoruesve të ndërtesave dhe publikut të gjerë.³

5. Mirëmbajtja në pasuritë kulturore

Në mbështetje të Ligjit nr. 27/2018, ndërhyrjet me karakter mirëmbajtës në pasuritë kulturore i referohen masave të vazhdueshme praktike dhe teknike për tu ndërmarrë për krijimin e kushteve maksimale me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi të pasurisë, për ruajtjen e vlerave kulturore si dhe veprimet parandaluese për kufizimin e situatave të rrezikut.

Kjo veprimtari realizohet nëpërmjet konservimit paraprak, mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe veprimeve parandaluese, me qëllim ruajtjen e vlerave kulturore të pasurisë.

Në këto raste përfshihen punimet me anë të të cilave nuk bëhet ndryshimi i organizimit të hapësirës në objekt, nuk prekin elementët e trashëgimisë kulturore, zëvendësimi i aparaturave, pajisjeve ekzistuese, si dhe ndryshimet, të cilat nuk ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit e nuk ndryshojnë elementët konstruktivë mbajtës.

³ Maintenance and Repair of Older Buildings

Burimi: Conservation Principles Policies and Guidance for the Sustainable Management of the Historic Environment – Historic England 2015

Maintenance and Repair of Older Buildings



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Sa më lart Këshilli Teknik, diskuton dhe miraton projektet-preventivat, relacionet dhe propozimet për ndërhyrjet emergjente dhe ato me karakter mirëmbajtjeje në monumentet e kulturës për parandalimin e mëtejshëm të dëmtimeve dhe zgjatjen e jetës së tyre, në pritje të ndërhyrjeve të plota restauruese, mbi bazën e një projekti restaurimi të miratuar në KKTKM.

6. Llojet e ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës në pasuritë kulturore (objektet arkitektonike dhe rrënoja arkeologjike)

A. Punimi pastrimi

- Pastrime nga bimësia (e ulët, e lartë dhe në lartësi) dhe në territorin përreth, dhe patina biologjike në plan / në fasadë (suva, muraturë), qemere, kupola, etj.;
- Pastrime nga depozitimet sipërfaqësore në fasada;
- Pastrim i fasadës nga pelikuli i bojës i degraduar, patina biologjike si pasojë e lagështirës nga ulluqet e dëmtuara;
- Pastrim nga llaçi i degraduar;
- Pastrim i fasadës nga pluhuri dhe depozitimet sipërfaqësore me ujë me pompë me presion (idropulitrice);
- Pastrim i fasadës në pjesët e shkruara me boboleta sprai me sverniciatore dhe larje me presion uji të ngrohtë;
- Pastrim i fasadës nga mbetjet e posterave, kollës, vinovil (e testuar) me presion uji të ngrohtë, me pas heqja me spatul metalike dhe furçë teli, duke ruajtur sipërfaqen e travertinës;
- Pastrim i njollave të zeza të çimçakizave dhe ndotjeve të tjera me dysheme me presion uji të ngrohtë, me pas heqja me spatul metalike dhe furçë teli, duke ruajtur sipërfaqen e travertinës;
- Pastrim hekuri nga ndryshku.

B. Punime fugatimi / suvatimi / lyerje

- Riparim suvatimi (mur guri, erker, çatma, qerpiç, tulle, etj) dhe retukim i pjesëve të dëmtuara të suvasë me llaç gëlqere / hidraulik;
- Fugatime të muraturës (pastrime mekanike, larje me ujë, fugatim);
- Lyerje e muraturës me gëlqere / sherbetisje / bojatisje hidromat / bojë cilësi e I-rë / etj.;
- Punimet e lyerjes me gëlqere, bojë vaji, antindryshk, antivol, vaj lini etj.;
- Lyerjet e fasadeve me ngjyrë të njëjtë me atë ekzistuese;
- Lyerje me antiruxho i elementëve metalikë.

C. Punime murature

- Konsolidime të kreut të muraturës (në mure ku nuk preket struktura e çatisë, në zona të kufizuara, mure rrethues, etj.);
- Riparime murature pjesore që nuk përbëjnë ndërhyrje konstruktive, në zona të kufizuara, mure rrethuese;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

- Konsolidim të kreut të muraturave në rrënoja me kapuçim dhe marrjen e masave për mbrojtjen e tyre nga reshjet e shiut në rastet kur është e nevojshme;
- Përf forcime themelesh në segmente të kufizuara;
- Marrje e masave për mënjanimin e lagështirës në muraturë (riparim i dëmtimit pjesor të mbulesës së çatisë, kanalizimeve, ulluqeve të dëmtuar / bllokuar etj.);
- Riparim pjesor i kreut të murit të dëmtuar, rivendosje e gurëve të rrëzuar në kreun e murit, fiksime me llaç gëlqere i gurëve të lëvizshëm në kreun e murit (mure mbajtëse, mure fortifikimi, etj.);
- Riorganizime të brendshme pa cenuar qëndrueshmërinë e objektit

D. Punime çatie

- Qeramosje çatije me rrasa guri, me tjegulla, furde / riparim pjesor strehë çatie (me tjegulla ose me rrasa guri);
- Zënie pikash;
- Riparime të pjesshme të strukturës së çatisë pa ndryshuar konfiguracionin egzistues të strukturës.;
- Restaurim pjesor çatie pa ndryshuar konfigurimin dhe strukturën;
- Izolim me fletë plumbi;
- Punime hidroizolimi / riparim ose F.V. ullukë shkarkimi V dhe H;
- Lidhje e shkarkimit të ulluqeve në kanalizimet përkatëse me qëllim mënjanimin e lagështirës në muraturë;
- Riparim në sistemin e kullimit të ujërave të shiut, riparim ulluqesh, kunetash, impluve etj.;
- Heqje dhe shtrime të shtresave termoizoluese në tarracë;
- Restaurim strehë çatie (me ose pa dekor);
- Riparim pjesor i strehës së dëmtuar / që rrezikon të bjerë;
- Restaurim oxhaku;
- Riparim i oxhaqeve / tymarëve.

E. Punime druri

- Riparime dritare / dyer / vetrata/ porta/ pragje druri;
- Restaurim pjesor dysHEME druri / tavan;
- Riparim parmakësh / F.V. parmakë, etj;
- Lyerje me antimol dhe vaj lini / bojë vaji / etj;
- Meretime të pjesshme të dyerve, dritareve, dysHEMEve, kangjellave metalike etj.;
- Marrje e masave për eliminimin e insekteve dëmtuese të materialit të drurit i ekspozuar ndaj lagështirës;
- Lyerje e ekstremitetit të trarëve të drurit me solucion mbrojtës ndaj ujit ;
- Vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;
- Restaurim dollap druri;
- Restaurim karrike druri;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

- Restaurim grila, qepena druri.

F. Punime në element arkitektonikë

- Riparim kornize e rrëzuar/ dëmtuar;
- Restaurime kornize dekorative nënçatie, kornizave përreth dritareve, kornizave të ndërkateve, elementëve veshës të xokolaturës;
- Riparim i shkallëve dhe korimanove;
- Restaurim i parapeteve;
- Ngjitje gurësh;
- Restaurim tiranta druri;
- Restaurimi i dekoracionit në fasadë dhe në interior.

G. Punime skelerie

- Marrjen e masave mbrojtëse emergjente me anë të puntelimeve në rastet e rrezikut nga shembjet të pasurive kulturore apo të elementeve të veçantë të tyre;
- Vendorsje skelerie dhe banerash.

H. Punime sistemimi

- Riparime muri rrethues pa ndryshuar konfigurimin;
- Sistemime oborri dhe mur rrethues;
- Realizim shkalle emergjente metalike;
- Realizim pandusi apo instalime të ashensorëve për PAK;
- Masat emergjente për mbrojtjen e pasurive kulturore nga lagështira;
- Riparime trotuaresh dhe riparime të pjesshme të shtresave të dyshemesë sipas tipologjive ekzistuese;
- Riparime të pjesshme të kalldrëmeve;
- Largim dherash nga muraturat e monumenteve;
- Ndërhyrje riparuese apo rehabilituese të sistemit të drenazheve;
- Tabelat sinjalistike;
- Riparime të Tabelave Informuese të monumenteve;
- Vendorsja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;
- Riparim kangjella për rrethim;
- Skarifikim bari me lopatë;
- Mbajllje bari.

I. Punime elektrike, hidraulike dhe mbrojtja nga zjarri

- Riparim i instalimeve elektrike të ekspozuara ose të papërshtatshme;
- Riparim i rrjetit elektrik të mbingarkuar;
- Përmirësimi i sigurisë (vendorsje e sistemit të kamerave CCTV);
- Punime mirëmbajtëse me karakter elektrik, dhe hidroteknik në funksion të pasurisë kulturore;
- F.V. Fikse zjarri;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

7. Llojet e ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës në pasuritë kulturore (veprat e artit)

A. Mozaiku

- Hapje dhe mbyllje e mozaikut në rastet e ekspozimit.
- Hapje dhe mbyllje mozaiku në rastet e kontrollit të gjendjes së konservimit (një herë në tre vjet), ndërrimi i plasmasit dhe gjeotekstilit, evidentimi i problematikave, pastrim i përgjithshëm nga depozitimet e paqëndrueshme (pluhurat ose bimësi e ulët), ndërhyrje konsoliduese rutinë (rivendosje taserash, injektme, bordurime, mbushje lakunash, etj.).
- Në rastet e mozaikëve të ekspozuar në muze, evidentim i problematikave, pastrim i përgjithshëm nga depozitimet e paqëndrueshme (pluhurat), ndërhyrje konsoliduese rutinë (rivendosje taserash të shkëputura, bordurime, etj.).

B. Objekte arkeologjike dhe elemente arkitektoknike

- Pastrim i përgjithshëm, bashkim fragmentesh, konsolidim paraprak i objekteve apo elementeve prej guri të dala nga gërmimi apo të ekspozuar në muze (skulpturë, elemente arkitektoknike të dekoruar, etj.). Këto ndërhyrje mund të realizohen në kantier ose në laborator.
- Pastrim i përgjithshëm, bashkim fragmentesh, konsolidim paraprak i objekteve arkeologjike të dala nga gërmimi apo të ekspozuar në muze (qeramikë, qelq, metale, etj.). Këto ndërhyrje mund të realizohen në kantier ose në laborator.

C. Piktura murale

- Ringjitime e pikturës murale me suportin.
- Konsolidim i pelikulit piktorik në rast rreziku të humbjes së ngjyrës.
- Bordurime të buzëve të pikturës murale kur ajo është e rrezikuar për të rënë.
- Vendosje e bendazheve me letër japoneze dhe merle (napë) për pjesë të rrezikuara të pikturës murale.
- Qepje me stukime e çarjeve dhe krisjeve që rrezikojnë rënien e pikturës murale.
- Pastrim i depozitimeve të paqëndrueshme (pluhura, rrjeta merimange, etj.).

D. Druri i dekoruar

- Montim i pjesëve të shkëputura të elementeve të materialit të drurit në rastet kur ato janë shkëputur nga suporti dhe rrezikojnë rënien në tavanet e dekoruara, ikonostase, amvonë, mafilë, mimerë, gjinekoni, apo objekte të tjera druri të dekoruar.
- Konsolidim i materialit të drurit kur ai është në gjendje të sfungjerizuar si pasojë e lagështisë.
- Konsolidim i pelikulit piktorik kur është i rrezikuar për të rënë.
- Dezinfektim i materialit të drurit kur ai është prekur në masë nga sulmi i insekteve ksilofagë.
- Pastrim i përgjithshëm nga depozitimet e paqëndrueshme (pluhurat, rrjeta merimange, etj.).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

8. Këshilli Teknik diskuton dhe miraton relacionet dhe propozimet për veprimtaritë arkeologjike si vijon:

- Dokumentimi i gjetjeve arkeologjike rastësore apo çfarëdo, pa cënuar kontekstin arkeologjik/substancën arkeologjike të tyre, brenda dhe jashtë zonave me status pasuri kulturore, me qëllim përgatitjen e relacionit për shqyrtim dhe vendimmarrje nga KKTKM.
- Pastrim në funksion të dokumentimit paraprak në rastin e gjetjeve arkeologjike rastësore, pa ndërhyrë ose cënuar shtresat arkeologjike/substancën arkeologjike.
- Lëvizja e gjetjeve arkeologjike të rrezikuara drejt ambienteve të sigurta, deri në përcaktimin e destinacionit final të tyre nga organet vendimmarëse (KKTKM).
- Marrja e masave mbrojtëse paraprake për gjetjet arkeologjike in situ deri në një vendimmarrje finale nga KKTKM.
- Kryerja e skanimeve gjeofizike me qëllim vlerësimin e substancës së nëntokës arkeologjike në zona me potencial, zona arkeologjike të shpallura me VKM, si dhe jashtë tyre.
- Kryerja e testeve gjeologjike me qëllim vlerësimin e qëndrueshmërisë së terrenit ku gjenden pasuritë kulturore (parqe arkeologjike, zona arkeologjike, monumente, si dhe zonat mbrojtëse të tyre), si dhe për identifikimin e problematikave të qëndrueshmërisë së pasurive kulturore.
- Kryerja e sondazheve për verifikimin e themeleve dhe identifikimin e problemeve strukturore në objekte me status pasuri kulturore, si dhe në objekte pa status brenda zonave arkeologjike "A" dhe "B", me qëllim hartimin e projekteve për shqyrtim dhe miratim nga KKTKM.
- Ndërhyrjet në objekte pa status në zonat arkeologjike "A" dhe "B", të cilat konsistojnë kryesisht në zëvendësimin e dyerve, dritareve, fasadave dhe çative, pa përfshirë ndërhyrjet në strukturë ose themele.

Përgatiti relacionin:

R. Papavasili

J. Mitrojorgji

G. Vokopola

M. Meshini

E. Vruzhi